



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

42
Nr. prot.

Tiranë, 16.01.2020

V E N D I M

Nr. 10 datë 16.01.2020

P Ë R

CAKTIMIN E DATËS SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË
DHE TË RENDIT TË DITËS

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 16.01.2020, në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë dhe të nenit 28, pikat 1, 2 dhe 3 të Statutit,

V e n d o s i:

1. Të thërrasë mbledhjen e Asamblesë më datën 21 shkurt 2020, ora 11.00, në sallën "Aleks Buda", me këtë rend dite:
 - Njohja me propozimet e komisioneve, të seksioneve dhe të vetë autorëve, nga anëtarët e Asamblesë dhe bashkëpunëtorët e saj, për botimet dhe veprimtaritë kërkimore-shkencore gjatë vitit 2020;
 - Miratimi i programit të plotë të aktiviteteve për vitin 2020;
 - Miratimi i rregulloreve të reja përkatëse në përputhje me Ligjin 53/2019 dhe Statutin e ASHSH;
 - Votimi i propozimeve të anëtarëve të Asamblesë dhe të Kryesisë së ASHSH për pranime të reja të anëtarëve të jashtëm;
 - Votimi për anëtarët e Asamblesë me statusin akademik i asociuar për avancim në titullin akademik.


1 | F a q e

Konceptoi:

Punoi:

2. Ngarkohen Sekretari Shkencor, kryetarët e seksioneve dhe kryetarët e komisioneve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim u bëhet i ditur anëtarëve të Asamblesë dhe shpallet në faqen zyrtare të institucionit.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
[Signature]
AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI



Konceptoi:

Punoi: